

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVA
GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
OSNOVNI SUD PRISHTINA – BASIC COURT OF PRISTINA

PKR.nr. 468/15

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA – në trupin gjykues të përberë nga gjyqtarja Shadije Gërguri-kryetare e trupit, gjyqtarëve Beqir Kalludra dhe Lumnije Krasniqi si anëtare të trupit gjykues me procesmbajtësin Arianit Mahmutaj në lëndën penale ndaj të akuzuarit R. A. për shkak të veprës penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm në tentativë në bashkëkryerje nga neni 229 par.4 nën.par.1 lidhur me par.3 dhe nenin 20 të ish KPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë, PP.nr.303-2/2012 të dt:25.11.2013, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësorë verbal e publik, në prezencën e prokurorit të shtetit Feti Tunuzliu, të akuzuarit R. A. dhe mbrojtësve të tij av.Y. O. dhe B. Sh., sias autorizimit me dt:**04.04.2016** të njëjtën ditë bjenë e në prezencë të palëve publikisht shpallë:

A K T G J Y K I M

I AKUZUARI:

R. A. me nofkën “R.” nga i ati R.dhe e ema E., e vajzerise A., i lindur me *data e lindjes...* në P., ku dhe tani jeton, lagjja “...” rr.”....”p.n., ka të kryer shkollën e mesme, i martuar, baba i 5 fëmijëve, ka qenë I punësuar dhe ka jetuar në Gjermani, më parë jo i gjykuar, ndaj të njejtit nuk zhvillohet procedure për ndonjë vepër tjetër penale, i gjendjes të dobët ekonomike, shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës. Në paraburgji, nga data 3.07.2013 deri me datën 4.04.2016 .

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: ekziston dyshimi i bazuar mirë se me dashje ka shtyt tjetrin të kryejë veprën penale, ashtu që më 26.04.2012, pasi kishin ardhë nga Shqipëria të pandehurit A.Gj., A. I. dhe F. S. dhe kishin qenë në garazhën e M. A. në P., lagjja ..., rruga “...” për ta parë dhe blerë narkotikun e sjellur nga Turqia e për ta dërguar në Shqipëri për shitje, por pas kësaj ishin kthyer pa e blerë për shkak të cilësisë së dobët me ç’rast, I pandehuri A.I. kishte marrë me vet si mostër rreth 1 gr të heroinës së përzier me kafein, I pandehuri R.A., të njëjtën ditë, në ora 20:03:00 minuta e ka thirrë prej telefonit të vet të pandehurin O.A. duke i thënë “Poshtë shkova, s’tpengova hiq, ndërsa kur i pandehuri O. A. i ka thënë ‘Spo bojke sish i mirë’”, i pandehuri R. A. me vetëdije të plotë e ka porosit të pandehurin O. A. duke i thënë: “Thirre atë haverin edhe kallxoj”, ndërsa kur I pandehuro O. A. i thot se nuk e di numrin e telefonit të tij, i pandehuri R. A. i premtun: “Ani se nesër unë të lidhi me to, kismet”, ndërsa në ora 20:07.10 minuta, i pandehuri R. A. prapë e thërret të pandehurin O. A. dhe i thot : “Fola me to qitash po vjen me pi kafe për nja 20 minuta, u bo hajt shko prite aty”, me dëshirë që ti tregoj të pandehurit O. A. për cilësinë e lartë të narkotikut dhe kështu i pandehuri R. A. është angazhuar seriozisht për ta bindur të pandehurin O. A. që ky të tentojë gjithësesi për t’ua shitur blerësve të sipërpërmendur lëndën narkotike dhe për rrjedhojë, të njëjtën ditë, në ora 20:33:52 minuta ai person e thërret të pandehurin O. A. prej nr., ndërsa në ora 20:35:33 minuta, të pandehurit O. A. i vjen mesazhi prej nr të tel.....: “po të pres në kafe”, ndërsa i pandehuri O. A. ia kthen në nr të tel: 905364608738 duke i thënë: “për pesë minuta po vij”, e pas këtij komunikimi i pandehuri O. A. me personin e panjohur shkojnë me “Golf 5” me targa *numër i targave...* në garazhën e M. A., ku i pandehuri O. A. kishte fshehur gjatë kësaj dite një thes me 8632.06 gram heroinë të përzier me kafein, dhe një thes tjetër 8369.154 gram heroinë të pastër,

-me çka ka kryer veprën penale Shtytje në veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm në tentativë nga neni 229 par.2 lidhur me nenin 24 dhe lidhur me nenin 20 e 23 të KPK-së.

Andaj gjykata me aplikimin e neneve të lartëcekura dhe neneve:

3,7,17,28,31,32,41,42,43,45,46, 73, 83 të KPRK-së dhe nenit 365 dhe 450 të KPPRK-së.

Për veprën penale Shtytje në veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm në tentativë nga neni 229 par.2 lidhur me nenin 24 dhe lidhur me nenin 20 e 23 të KPK-së. **DENIM ME GJOBË** në shumë prej **5.000 € (pesë mijë) euro**, dhe **DENIM ME BURGIM** në kohëzgjatje **3(tre) vite** i cili dënim do të ezkeketohet në afat prej 15 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit. Në këtë dënim i llogaritet koha e kaluar në paraburgim nga data **3.7.2013 deri me dt. 4.04.2016**.

Në rast se denimi me gjobë nuk mund të realizohet as me detyrim konform nenit 46 par.3 te KPPRK-së, gjykata këtë dënim me gjobë do ta zavendësoi me dënim burgu konform nenit 46 par. 3 te KPPRK-se, ashtu që 20 € (euro) , të dënimin të shqiptuar llogaritet me një ditë burgim.

I akuzuari **R.A.**, obligohet të paguajë shpenzimet e procedurës penale sipas llogarisë të kësaj gjykate, ndërsa në emër të paushallit gjyqësor të paguajnë shumën prej 200 € (**dyqind**) Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi.

A r s y e t i m

Prokurorija Themelore në Prishtinë, Departamenti për krime të rënda ka ngritë aktakuzë PP.nr.303-2/2012, të dt: 25.11.2013 kunder të akuzuarit R. A. për shkak se bashk me O. A., A. Gj., A. I. dhe A. K. si dhe të pandehurin F. A. (në arrati) ka kryer vepren penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshem në tentativë nga neni 229 par.4 nën.par.1 lidhur me par.3 dhe nenin 20 KPK –së.

Gjykata Themelore në Prishtinë me aktgjykimin PKR.nr.1064/13 të dt. 22.12.2014, i akuzuari R. A. e ka shpall fajtorë për vepren penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm në tentativë në bashkëkryerje nga neni 229 par.4 nën.par.1 lidhur me par.3 dhe nenin 20 të ish KPK-së dhe e ka gjykuar me denim me gjobë në shumë prej 5000 euro dhe denim me burg në kohëzgjatje prej 5 vite duke i llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim prej dt. 3.7.2013 e më tutje, ku më aktvendimin e veçantë ju është vazhduar paraburgimi deri sa aktgjykimi e merr formën e prerë, por jo ma shumë se koha e denimit të shqiptuar.

Me aktvendimin e Gjykatës e Apelit PAKR nr.352/2015, është miratuar ankesa e mbrojtësëve të akuzuarit av.Y. O. dhe av.B. Sh., ashtu se sipas detyrës zyrtare aktgjykimi i gjykatës Themelore në Prishtinë, departamentit për krime të rënda është anuluar dhe çështja është kthyer në rigjykim .

Duke vepruar sipas sugjerimeve të Gjykatës së Apelit, Gjykata Themelore në Prishtinë , Departamenti për krime të rënda ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësorë në këtë çështje penale –juridike .

Prokurori i shtetit Feti Tunuzliu në fjalën përfundimtare fillimisht e ka bërë ndryshimin dhe precizimin e dispozitivit të aktakuzës ashtu që i akuzuari R.A. e akuzon, sepse ekziston dyshimi i bazuar mirë se me dashje ka shtyt tjetrin të kryejë veprën penale, ashtu që më 26.04.2012, pasi kishin ardhë nga Shqipëria të pandehurit A.Gj., A.I. dhe F. S. dhe kishin qenë në garazhën e M. A. në P., lagjja ..., rruga “...” për ta parë dhe blerë narkotikun e sjellur nga Turqia e për ta dërguar në Shqipëri për shitje, por pas kësaj ishin kthyer pa e blerë për shkak të cilësisë së dobët me ç’rast, I pandehuri A. I. kishte marrë me veti si mostër rreth 1 gr të heroinës së përzier me kafein, i pandehuri O. A., të njejtën ditë, në ora 20:03:00 minuta e ka thirrë prej telefonit të vet të pandehurin R. A. duke i thënë “Poshtë shkova, s’pengova hiq, ndërsa kur i pandehuri O. A. i ka thënë ‘Spo bojke sish i mirë’, i pandehuri R. A. me vetëdije të plotë e ka porositur të pandehurin O. A. duke i thënë: “Thirrë atë haverin edhe kallxoj”, ndërsa kur I pandehuri O. A. i thot se nuk e di numrin e telefonit të tij, i pandehuri R. A. i premtun: “Ani se nesër unë të lidhi me to, kismet”, ndërsa në ora 20:07.10 minuta, i pandehuri R. A. prapë e thërret të pandehurin O.A. dhe i thot : “Fola me to qitash po vjen me pi kafe për nja 20 minuta, u bo hajt shko prite aty”, me dëshirë që ti tregoj të pandehurit O. A. për cilësinë e lartë të

narkotikut dhe kështu i pandehuri R. A. është angazhuar seriozisht për ta bindur të pandehurin O. A. që ky të tentojë gjithësesi për t'ua shitur blerësve të sipërpërmendur lëndën narkotike dhe për rrjedhojë, të njejtën ditë, në ora 20:33:52 minuta ai person e thërret të pandehurin O.A. prej nr., ndërsa në ora 20:35:33 minuta, të pandehurit O. A. i vjen mesazhi prej nr të tel.: “po të pres në kafe”, ndërsa i pandehuri O.A. ia kthen në nr të tel: duke i thënë: “për pesë minuta po vij”, e pas këtij komunikimi i pandehuri O. A. me personin e panjohur shkojnë me “G.5” me targa *numër i targave...* në garazhën e M. A., ku i pandehuri O. A. kishte fshehur gjatë kësaj dite një thes me 8632.06 gram heroinë të përzier me kafein dhe një thes tjetër 8369.154 gram heroinë të pastër.

Prokurori i çështjes vlerësoi se provat e administruar gjatë shqyrtimeve gjyqësore kanë konfirmuar dyshimin e bazuar mirë se i akuzuari ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet, edhe përkundër mohimit kategorik të të akuzuarit R. A. se nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet. Transkriptet e përgjimeve të telekomunikimit - mesazheve vërtetojnë saktësisht përgjimet e komunikimeve zanore dhe tekstuale, përmes rrjeteve të telefonisë mobile . Transkripti I bisedes telefonike të dt. 26.4.2012 prej orës 20:07:0 konfirmon thirrjen telefonike që ia bënë I akuzuari R. A. prej nr. të tel. , të akuzuarin O. A. në tel/ nr. Nga ky transkript vërejtet se I akuzuari R. A. i thotë të akuzuarit O. A. “Fola me to , qitash po vjen me pi kafe nja 20 min “ dhe e porosit “Hajt shko prite aty “ , nderkaq , ne biseden tjetër telefonike të zhvilluar në orra 20:55:40 min. I akuzuari R. A. tregon për interesimin e tij rreth këtij takimi duke e porositur perseri O. “Thire atë haverin edhe kallxoj”, nderkaq kur I akuzuari O. A. i tregon se nuk ka nr. të tij të telefonit, kërkon ndërhyrje e të akuzuarit R. A. i cili pranon duke I premtuar se “Ani hajt se të lidhi me to, kismet”. Nga fotoalbumi I njesisë së forenzikës ilustrohen ambientet e garazhës së M. A., vëllaut të akuzuarit në lagjen në rrugën, ku edhe është gjetur narkotiku nga hetuesit e DHTN . Fotografitë e dala nga CD së vëzhgimit të fshehtë, ilustronë pamjet e tre të akuzuarëve duke hypë në veturë Audi A8 me targa *numër i targave...* të ndalur pranë garazhës së M., ku është fshehur lënda narkotike . Procesverbali I bastisjes, vërtetonë se në prezencën e deshmitarëve janë konfiskuar përveq tjerash edhe 18.363 kg substances narkotike, të llojit heroin . Në fund gjykatës I ka propozuar se I akuzuari të shpallet fajtor dhe përgjegjës për veprën penale në fjalë dhe të denohet sipas ligjit.

Mbrojtësi i të akuzuarit av.Y. O. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se prokurori I shtetit nuk ka arritë as përsëafërimi të provoj se I akuzuari R. A. në çfardo mënyrë të këtë kryer veprën për të cilën ka qenë I akuzuar deri me tani, dhe për të cilën po akuzohet sot . I ka propozuar që gjykata në mungesë të provave të njejtin ta liroj nga akuza, duke I propozuar edhe nderprerjen e paraburgimit.

I akuzuari R. A. në tërsi e ka akceptuar fjalën përfundimtare të mbrojtësve dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se nuk ka asgjë tjetër për të shtuar.

Gjykata pas vlerësimit të provave të proceduara një nga një dhe të gjithave së bashku ka vërtetuar gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjendja faktike në këtë qështje penalo –juridike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë në bazë të procesverbalit mbi bastisjen e shtëpisë së R. A. të dt 26.4.2012 , procesverbalit e bastisjes së shtëpisë së M. A. të dt 26.4.2012, vërtetimit mbi marrjen e përkohëshme të sendeve të dt.26.4.2012, vërtetimit për konfiskimin e sendeve prej T. M., analizës laboratorit qendres së kriminalistike 2012-1260 të dt. 26.4.2012 . Raportit të ekspertizes nga njësjia e shkencave ligjore të dates 13.7.2012, deklaratës së të akuzuarit O. A. të dhënë në polici me dt. 7.5.2012,transkriptet e bisedave telefonike të zhvilluar në mes të O.dhe R. A. të dt 26.4.2012 , fotokopje të biletave aeroplane për të akuzuarin dhe bashkëshorten e tij lidhur me udhëtimin në Dubai për dt.23.4.2012.

Qërtifikaten për R. A. që nuk është nën hetime si dhe premtimit (sigurimi) I nënshtetësisë, konstatimi dhe sqarimi për automjetin P. me targa të *numër i targave...* nga autosalloni “B.” të dt.18.4.2014, nga raporti i vëzhgimit të dt.26.04.2012 , me memorandumin zyrtarë të dt.11.02.2016 nga sektori për përgjime ligjore, dhe në fund e ka ndigjuar të akuzuarin dhe deklaratën e tij e ka marr si prove, kurse me aktvendimin e veçant e ka shpall proven e papranueshme deklaratën e deshmitarit H. Sh. .

c

Nga procesverbali i bastisjes së shtëpisë së të akuzuarit ,tani të ndjerit R. A. nr 002164591, një patent shofer të lëshuar nga Gjermania me nr. të datës 26.4.2012, është vërtetuar se në atë shtëpi gjatë bastisjes është gjetë një pasaport në emër të R. A. me nr..... të lëshuar nga UNMIK-u , një pasapart Jugosllav në emër të R. A. me nr. , një kartelë bankare në emër të R. A. plus , një kartelë e. u. në emër të akuzuarit R. A. me nr, një kartelë o. në emër të R. A. –S. nr. , një kartë e kartelës telefomike Vala –nr , një telefon N. me ngjyrë hiri me imei , një kartelë L.mobil nr..... dhe një llap top i firmës “HP”nr.

Nga procesverbali i bastisjes së shtëpisë së M. A. të datës 26.4.2012, është vërtetuar se në atë shtëpi është gjetë substance narkotike të llojit heroin e cila peshon gjithësej 18.363kg.

Me vërtetimin mbi marrjen e përkohshme të sendeve, është vërtetuar se më dt.26.4.2012 nga R. A. është konfiskuar një revole TT 7.65 mm me 7 fishek , dy karikator të kalibrit 7.65 mm , 18.363 kg supstancë narkotike që dyshohet se është Heroin e ndarë në qese, një makinë për paketimin e qeseve , dy rollna me foli, një shpakull për përzierjen të subsatncave ,një pasaport të UNMIKU-ut me nr. KO..... , një pasaport Jugosllav , një patent shofer Gjermanë , tri kartela bankare. me nr. , , , një kopertinë të karteles telefonike V., një telefon celular N..... , një kartelë telefonit L..... , një lllaptop HP, një veturë G. 5ngjyrë kuqe *numër i targave....*, një veturë B. X6 *numër i targave...*, dhe qelësi i veturesX6.

Me vërtetimin mbi konfiskimin e gjësendeve të datës 27.4.2012 vërtetohet se nga T. A. janë konfiskuar një tel n. me kartelë , një telefon S. me kartelë, një telefon nokia me kartelë , një telefon n. me kartelë , një telefon S. me kartelë, një telefon n. E.... pa kartelë , një telefon n.me kartelë, një kartelë memorike 26 B, pesë shirita koghuasheng , dy shirita victory , katër shirita office line të kuq , dy shirita nëë star tap , dy pako me folia, një pako me dorëza plastike , një paketim i madh me qese të vogla

plastike, një peshore të vogël, dy paketime të vogla me peshë 2,3 gram dhe një kablo për memori kard.

Sipas analizës të laboratorit qendror të kriminalistikës nën A sipas numrit të laboratorit 2012 -1260 vërtetohet se nga të akuzuarit R. A. dhe O. A. me datën 26.4.2012 në ora 21:40 janë marrë 36 pako që dyshohet të jetë heroinë të vendosur në një thes të letres , 16 pako që dyshohet të jetë heroinë të vendosur në një thes të letres , tri folia të mbështjell të future në një pako të letres , dy revole bereta nr. Lo9892 dhe revole ecola tuna nr. V741852 të vendosura në një pako të letres , 50 fishek të kalibrit 7.65 , një revole TTnr88741 dhe shtat fishek të kalibrit 7.65 mm

Sipas analizës të dëshmive në laboratorin qendror të kriminalistikës nën C me nr.2012-1260 është vërtetuar se me dt.15.5.2012 gjatë hetimit të rastit janë konfiskuar 54 qese të cilat janë të mbushuar me një substancë e cila dyshohet të jetë heroine dhe është kërkuar që të bëhet ekzaminimi i substancës së dyshuar.

Nga raporti i ekspertizës të njësisë shkencave ligjore, analizës kimike, raporti i ekspertizës të dt.13.7.2012 është vërtetuar se me aplikimin e metodave dhe paisjeve, me testin e ngjyres, kromatografin e gazrave ka rezultuar ekspertimi dhe konstatimi se ekzaminimi i substancës të fort si guri dhe pluhur me ngjyrë kafe të çelët nga deshmëtë detalisht të përshkruar si në këtë ekspertizë , është present narkotiku- Heroina.

Sipas mendimit përfundimtarë pesha neto e përgjithëshme 8632.06 gram përmbanë Heroinë dhe gjurmë të kafeinës, ndërsa pesha neto e përgjithëshme e përëafërtë 8369.154 gram, është narkotiku heroina.

Në bazë të transkriptit të mesazhave për bisedën telefonike të zhvilluar në mes të akuzuarit R. A. dhe O. A. , është vërtetuar se me datën 26.4.2012 në orë 20:03 R. e thret O. me telefon duke e pyetur që po bonë dhe I thotë “shkova stpengova hiq “.O. I thotë” spo bojka as ky kerri bre” dhe shton” Spo bojka bre sish I mirë” .R. I thotë” thire atë haverin edhe kallxoj” , por O. nuk e ka numrin e telefonit dhe e porositë R. mi thon për mu lajmëru tek O., se pastaj ata dy flasin nëpërmes internetit, si të gjithë . Në orë 20:07:10 R. e thret O. dhe I thotë se ka folë me atë person dhe I njejtë I thotë “qitash po vjen me pi kafe për një 20 minuta “dhe I thotë” hajt shko e prite aty ” .Pastaj në orë 20:35:33 I ka ardh një sms në gjuhën turke që në përkthim I bjen” po të pres në kafe” , kurse O. ia kthen “për pes minuta po vij” .

Me deklaratën e të akuzuarit O. A. të dhënë në polici me datën 07.05.2012, është vërtetuar se gjatë pushimit verorë kur ka qenë në Shqipëri në vitin 2011 është njoftuar me një person nga Shqipëria, i quajtur A.. I kanë shkembue numrat e telefonave dhe me një rast deri sa kanë qenë duke pirë kafe kur e ka thirrë daja nga Turqia dhe ka biseduar në gjuhën turke ,A. ka kërkuar nga O. nese mundet mi ja transportuar drogen nga Turqia për në Shqipëri dhe pasi që ka biseduar me B. nga Turqia ka pranuar me transportue drogen për 2.000 Euro për gjdo kilogram të drogës , ku 1.500 Euro kanë qenë për B. , ndërsa 500 Euro për këtë. Pasi që personi nga Shqipëria i ka dërguar paratë te një person në Turqi , B. e ka sjell drogen në Prishtinë , një ditë para se me hy policija në kontrollë .

B. ja ka dhënë dy thasë me ngjyrë të bardhë që nuk kanë qenë të madhësisë së 50 kg , por ma të vogël, dhe për këto thasë B. i tha që ka qenë droga e cila peshon 18 kg dhe është e dedikuar për A. nga Shqipëria. Në bagazhin e taksit i ka vendosë thasët dhe të njëjtat i ka que në shtëpinë e vëllait, të akuzuarit M. A.. Paraprakisht nga babai i ka marr qelësat e shtëpisë së M. dhe në garazhen e shtëpisë së tij i ka vendosë dy thasë me narkotikun, ashtu si ishte porositur nga A. nga Shqipëria, dhe derisa ishte në shtëpinë e M. së bashku me shokun A. ka ardh policija, atëherë ata dy kanë hypë në kulmin e shtëpisë dhe kanë kërcyer në tokë nga lartë dhe nga aja kohë nuk e ka parë A.. Nuk i kujtohet që ka kontaktuar me telefon me nr. dhe që i ka thënë se kerri nuk është i mirë , e as nuk është i sigurt që atë ditë ka kontaktuar me vëllaun, R. A., por me siguri po, ka biseduar dhe biseden e ka zhvilluar me telefonin dhe ndoshta i ka thënë R. që kerri nuk është i mirë. Fjala ka qenë për veturen P. CC dhe për R. ka thënë se ka qenë para dite në shtëpi, sepse R. rreth ores 15:00 është nisur ne pushime, jasht Kosovës me bashkëshorten e tij.

Me kartelën telefonike që është gjetur në shtëpinë e R., është vërtetuar se numri është përputhur me numërin me të cilin ka biseduar O. me R. ,poashtu është vërtetuar se vetura fare nuk ka pasur para shtëpisë, përpos që vetura ‘P.’ me targa *numër i targave...* është konfiskuar tek shtëpia e O., e cila shtëpi është në distancë të largët nga shtëpia e M..

Duke bërë vështrim në fotokopjen e biletave është vërtetuar se bashkëshortja e të akuzuarit, S. K. në agjencionin F. A. T. me datën 23.04.2012 i ka siguruar dy bileta për udhëtim nga Prishtina për në Istanbul (për dt: 26 prill) dhe Istanbul –Dubai(për dt. 27 prill). Rezervimi ka qenë deri me datën 03.05.2012 .

Me çertifikaten që nuk është nën hetime të datës 7.8.2012 të lëshuar nga Zyra Federale e Drejtësisë, është vërtetuar se R. A. i lindur me dt *data e lindjes...* , nuk ka regjistrim, apo shenim në dosje.

Me premtimin (sigurimin) e shtetësisë nga Qarku, Autoritete për të huaj vërtetohet se R. A. me vendbanim në E., K. P., premtohet shtetësisja, nese deshmohe humbja e nënshtetësisë kosovare. Sigurimi I nënshtetësisë vlen deri me datën 18.6.2014 dhe e njëjta ipet me kusht që nuk ndryshohet gjendja dhe rrethanat juridike për shtetësin , në veçanti mardhënjet personale të kandidatit për shtetësi.

Me sqarimin nga autoservisi “B. “-automobile të dates 18.4.2014, vërtetohet se ky autoservis nga O. A. me datën 18.4.2012 ka pranuar një veturë V. P. me targa të regjistrimit *numër i targave...* për shkak të kontrollimit të timonit që sillet me vesh tërësi , kur e kthen timonin nuk kthehet vet –veti si duhet . Automjeti në fjalë ka dalë nga autoservisi me të njëjtën datë, rreth ores 16:00.Kjo vërtetohet edhe me faturen nr 1-61 /121347dhe vulen e autoservisit “B. “ që është bërë pagesa për sherbimin e kryer. Biseda në mes të O. dhe R. është zhvilluar me dt: 26.04.2016, çka do të thot se pas 8 (tetë) ditësh prej kthimit të automjetit nga auto-salloni në fjalë.

Me raportin e vëzhgimit të datës 26.4.2012 ,vërtetohet se në ora 18:34 është lokalizuar O.me veturë B. X6 me ngjyrë të zezë me targa *numër i targave...* . Në orra 18:42 një

vetryrë G. ngjyrë e zezë ka ardhur tek autolarja O. ka hipë në këtë veturë dhe pasagjerë dhe kanë vazhduar ne drejtim të shtëpisë së O., në M. –Prishtinë . Në orra 18 :55 vetura G.6 ngjyrë të zezë arrinë tek shtëpia e O. aj zbret nga vetyra dhe hynë në shtëpi, ndersa para shtëpisë së tij kanë qenë të parkuara dy vetura P. me ngjyrë hiri me targa *numër i targave...* dhe një A. A8 ngjyrë zezë me targa të Shqipërisë *numër i targave...* . Në orra 19:20 vetura A. A8 e zezë me targa *numër i targave...* kthehet në anen e majtë përball varrezave dhe vazhdon 100 metra dhe kthehet në anen e djathët pas 50 metrave duke u ndal tek shtëpia e vëllaut O.. Hetuesit e vëzhgojnë gjdo levizje të personave, e sidomos O. dhe në orra 21 ;25 e lokalizojnë O. në restorantin G. ku është ulur me një femër dhe dy meshkuj . Në orra 22:04 O.me këta persona dalin nga restorani G. dhe me një mashkull hipë ne veturen G. 5 ngjyrë kuqe me targa *numër i targave...* , pastaj aja veturë ndalet para shtëpisë se M. dhe O. bashk me atë personë hynë në shtëpi. Në orra 22:18 njësjia policorë hyjnë në shtëpin e M. A..

Nga memorandum zyrtarë I dt . 11.02.2016 vërtetohet se sektori i përgjimeve ligjore me të përfunduar masen e fshehtë e përgjimit të telekomunikimeve me kërkesë të hetuesit përgjegëjs të gjithë materjalët e mbledhura gjatë zbatimit të masës së fshehtë duke përfshirë CD-të me të dhënë elektronike dorëzohen tek zyrtari i autorizuar i cili pastatj këtëo materjale do të duhej të procedojë tek Prokurori kompetent i rastit.

Duke vepruar sipas urdhëresës e gjykatës të dt. 10.2.2016 për sigurimin e përgjimit ligjor për periudhën kohore prej tre muaj, nga muaji janar deri ne muajin prill 2012 për bisedat e zhvilluar në mes të akuzuarit O. A. dhe R. A. me numër të telefonit nepërmesë njoftimit nga Sektori në fjalë kemi kuptuar se ky sektor nuk e posedon ndonji kopje elektronike për rastin në fjalë dhe asnjë të tillë për periudhën e vitit 2012, pasi që ato të dhënë elektronike janë shkaktuar në përputhje me legjislacionin në fuqi.

I akuzuari R. A. në shqyrtimin gjyqësorë nuk e ka pranuar kryerjen e vepres penale për të cilën akuzohet dhe ne mbrojtjen e tij ka shtuar se ka punuar dhe jetuar në Gjërmani dikun njëzetë vitë me radh, ndersa familja e tij bashkëshortja dhe pes femijë kanë jetuar në Prishtinë. Me vëllëzërit ka qenë I ndamë ashtu se vëllau i tij M. ka jetuar në një shtëpi, e poashtu edhe vëllau tjetër O. e ka pasur shtëpinë e vet. Me O. ka komunikuar me telefon shum shpesh . Me datën 26.04.2012 ka ardhur nga Gjërmanija në Prishtinë për me marr bashkëshorten më qellim për të shkuar në pushim, sepse e ka pasur pushimin e rezervuar për në Dubai. Pushimin e ka pasyr te rezervuar më heret , ndersa biletat I ka marë dy ditë para datës, 26.04.2012. Atë ditë kur ka ardhur nga Gjermanija pasi që është takuar me prinderit dhe me familjen e tij ,atë ditë dikun pas dite rreth ores 17:00 ka fluturuar nga Prishtina në Stamboll dhe nga Stambolli për në Dubai, me bashkëshorten K.. Pas kalimit të pikes kufitare janë ndal me pritë aeroplanin, e ka thirë O. mu intresue për fëmijtë, meqënëse atë ditë ka udhëtuar vetëm me bashkëshorten. Kur u lajmërua O. në telefon, nga aj ka kuptuar se vetura është e prishur dhe i ka thënë O. me thirë pronarin e kerit për ti tregura se vetura është e prishur. O. i ka thënë se nuk e ka numrin dhe i ka thënë për me thirë ky . Fjala ka qenë për veturen P. CC me ngjyrë hiri dhe për këtë veturë ka ditur se O. e ka marr nga autosalloni “Sh. “ në veternik të Prishtines .Të njejten veturë O. e ka marr veresi me qëllim që ta shes, sepse në atë kohë e kanë poseduar

autoservisin dhe O. është marë me shitjen e automobilave .Ka ndodh se O. I ka marr veturat të përdorura dhe I ka rregulluar duke i shitur ma shtrejt . Ka pohuar se ka kontaktuar pronarin e vetures emrin e të cilit nuk e dinë dhe të njejtit i ka thënë mu takue me O. për shkak se kerri nuk është në regull, është i prishur. Pronari i vetures ka thënë se do të shkon te O., përseri e ka thirë O. duke i tregua se pronari do të vjen tek aj . Pushimi në Dubai në të cilin ka shkuar me bashkëshorten ka qenë i rezervuar për një javë ditë dhe nga Dubai ka shkuar për në Gjërmani, ndersa bashkëshortja e tij K. është kthyer në Kosovë. Per O. që ka qenë I implikuar në rastin e narkotikut ka kuptuar gjatë qendrimit të tij në Dubai, sepse motra e tij S. i ka lajmëruar se policija ka qenë në shtëpin e O. dhe e ka bërë bastisjen e shtëpisë dhe e kanë gjetë drogen , ne shtëpinë e M.. Nuk ka ditur se organet e ndjekjes po e kërkojnë për shkak të dyshimit se është bashkëkryes i vepres penale të narkotikut. Ka biseduar me prindin por i njejt i asnjherë nuk i ka thënë se prokurorija po e kërkon, dhe po të kishte ditur se prokurorija po e kërkonte vet kishte ardhur ,sepse nuk e ka bërë një vepër të tillë penale.

Gjykata mbrojtjen e të akuzuarit R. A. si dhe tezen e avokatëve, mbrojtësëve të tij i ka vlerësuar duke i hedhur posht si të pabazuar dhe në kundërshtim me provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësorë.

Gjykata duke vlerësuar pretendimet dhe propozimet e mbrojtësve ka ardhur në përfundim se pretendimet e mbrojtësve dhe propozimet nuk i ka aprovuar, për arsye se nga mbrojtja e dhenë në shqyrtimin gjyqësorë dhe në bazë të provave të administruara në shqyrtimin gjyqësorë ndryshe është vërtetuar gjendja faktike, e jo siç kanë pretenduar dhe propozuar mbrojtësit.

Gjykata gjatë analizimit dhe vlerësimit të provave të administruara ,veçanarisht gjatë analizimit të procesverbalin e bastisjes së shtëpise së M. A. me datën 26.4.2012 me të cilën është vërtetuar se në atë shtëpi është gjetur substance narkotike të llojit heroin ne peshë prej 18.363 kg. Vertetimit mbi marjen e përkohëshme të gjësendeve nga R. A. ku ne mes te gjësendeve jane gjetë dhe konfiskuar 18.363 kg substancë narkotike që dyshohet se është heroin e ndarë në qese , një makinë për paketimin e qeseve, dy rollne me foli , një shpakull për përzierjen e narkotikut, të njejtat i va vënë në lidhmëni me njëra me tjetrën në mënyrë që ta ndërtoj një pasqyre reale të zhvillimit të ngjarjes.

Me vërtetimin mbi konfiskimin e gjësendeve të dt 27.4.2012, është vërtetuar se tek T. A. ne mes të gjësendeve që janë konfiskuar kanë qenë dy pako me folie , një pako me dorëza , një peshorë të vogël , dy paketime të vogla me peshë prej 2,3 gram të narkotikut ,që qojnë tek konkludimi se të gjitha kanë qenë të parapara si mjete për përgaditjen e narkotikut për shitje e paautorizuar.

Me deponimin e deklaratës së të akuzuarit O. A. të dhënë ne polici 7.5.2012, e cila sipas gjykatës është provë e pranueshe, sepse e njejta është marë konform dispozitave ligjore dhe në prezencen e mbrojtësit, është vërtetuar se O. me A. nga Shqipëria është marr vesh mi ja transportuar drogen nga Turqija, pasi qe ka biseduar me B. nga Tyrqija, dhe janë dakorduar që për gjdo kilogram droge të paguaj nga 2000 euro, ku 1500 euro kanë qenë të parapara për B., ndersa 500 euro per O. . B. I ka sjell dy thasë me narkotikun dhe

ato O. I ka vendosë në shtëpin e M. A., dhe deri sa ka qenë me A. në shtëpin e M. ka ardhur policija dhe ata dy kanë hypë në kulmin e shtëpisë dhe kanë ikur nga vendi I ngjarjës .

Nga transkripti i përgjimeve të bisedave telefonike midis të akuzuarit R. A. dhe të akuzuarit O. A. të dt 26.4.2012, gjykata ka vërtetuar se i akuzuari R. A. gjatë udhëtimit për në Dubai personalisht e thret të akuzuarin O. duke i thënë "shkova stpengova hiq", me çrast kuptoi nga O. se narkotiku i importuar nuk është i kualitetit të mirr dhe me mesazhin e kamufluar "spo bojke as ky kerri bre "I njejt aludon ne narkotikun dhe është kodi për substancën narkotike, atëherë i akuzuari R. i premtion duke i thënë "hajt se nesra te lidhi me to, kismet", e pastaj përseri i telefonon O. duke i thënë "folta me to qitash po vjen me pi kafe, për nja 20 min " dhe vazhdon duke i thënë "hajt shko prite aty ". Është vërtetuar se lidhjen me shtetasin turk e bëri R., sepse pas pak kohe O. i ka ardhur një mesazh në telefon në gjuhën turke "për pesë minuta vi ".

Nga raporti i ekspertizës të hartuar nga Agjencija Kosovare për forenzikë , njësisja e shkencave ligjore dhe analizë kimike, saktësisht nga Adelina Nimanaj –Halili -eksperte për analiza kimike të drogave dhe eksplozivave, është konstatuar se është fjala për substance narkotike - Heroinë, narkotikun e katagorizuar në tabelë të ligjit për barnat narkotike, substancave psikotropike dhe prekursorë.nr.02/L-128.

Nga provat që janë argumentuar në shqyrtimin gjyqësorë , është vërtetuar si I akuzuari R. A. vepron penale për të cilën është shpall fajtor dhe i përgjegjshëm e ka kryer me paramendim, sepse ka qenë i vetëdijshëm për veprën e vet penale dhe e ka dashur kryerjen e saj.

Gjykata ka vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit, egziston dashja për kryerjen e vepres penale dhe e njejt është kryer për qëllimet e caktuar (dollus coloratus) dhe për këtë arsye i njejt është penalisht përgjegjës për kryerjen e vepres penale për të cilën prokurorija ka ngritë aktin akuzues.

Nisur nga faktet dhe provat të administruara, është vërtetuar se i akuzuari ka qenë i vetëdijshëm mbi veprimet e tij inkriminuese, pasojen e ndaluar ligjore të cilën e ka dëshiruar. Është e vërtetë se në veprimet e tij përmbushën të gjitha elementet objektive dhe subjektive të veprës penale Shtytje në veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm në tentativë nga neni 229 par.2 lidhur me nenin 24 dhe lidhur me nenin 20 e 23 të KPK-së. të përshkruar si në dispozitiv të aktgjykimit, është penalisht përgjegjës, ka poseduar aftësi intelektuale dhe volitive që I bënë të mundëshme të mendojë, gjykojë, të vendosë dhe ti kontrolloi veprimet e tij . Ishte në gjendje që ti kuptojë veprimet e tij inkriminuese , të vetëdijshëm për rëndësinë dhe pasojat e veprës penale, gjendje kjo që i mundësonë që veprën ta kryen me vetëdije dhe vullnetë të vet. Kishte paraftyrim të qartë se është duke kryer vepër penale të rrezikëshme dhe të kundërligjshme .

Me administrimin e provave materjale, transkriptin e mesazheve telefonike, video-inqizimeve, fotoalbumeve, deklaratës së të akuzuarit O. A., është vërtetuar se i akuzuari

R. A. është angazhuar për importimin e narkotikut nga Turqia duke vepruar me dashje dhe duke qenë i vetëdijshëm se është fjala për narkotikun heroin, I cili është i rrezikshëm për shëndetin e njerëzëve dhe me dt 26.4.2012 gjatë ditës ,disa herë ka komunikuar me O. A. me SMS me gjyhen e kodeve, kinse duke u interesuar për veturen P. e cila sipas fjalëve të O. është e prisht , mirpo gjykata vlerësoi se biseda u zhvillue me gjuhën e kodeve për mallin e narkotikut që ka ardh nga Turqia për në Shqipëri dhe se nuk është e kualitetit të mirë.

Gjatë vlerësimit të provave të prezentuar në shqyrtimin gjyqësorë që kanë të bëjnë me përgjegjësi penale të të akuzuarit R. A., gjykata nuk ka gjetur asnjë bazë për perjashtimin, apo zvoglimin e përgjegjësisë e tij, prandaj të njejtin e ka shpall fajtor për kryerjen e veprës penale të rikfalifikuar nga ana e prokuroritë .

Duke patur parasysh te cekurat , gjykata ka marrë qendrim se ne veprimet e të akuzuarit formohen elementet e veprës penale Shtytje në veprën penale Blerja, posedimi, shpërndarja dhe shitja e paautorizuar e narkotikëve të rrezikshëm në tentativë dhe në bashkëkryerje nga neni 229 par.2 lidhur me nenin 24 dhe lidhur me nenin 20 e 23 të KPK-së.

I akuzuari R. A. ka qenë i vetëdijshëm se me veprimin e tij shtytë të akuzuarin O. A. e te tjeret të kryen veprën penale nga neni 229 par.2 dhe njëherit dëshiron kryerjen e saj, sepse me ndërmjetësimin, interesimin dhe premtimin se do ta koordinon takimin me B. për shkak të cilësisë së dobët të narkotikut në momentin kur nga O. e pranon mesazhin “Spo bojka sish i mirë “ I përgjigjet mesazhit të O. kur aj kërkon ‘Thirre atë haverin edhe kallxoj ‘atëherë I akuzuari O. I thot se nuk ka numrin e tij të telefonit, atëherë I akuzuari R. I premtun “ Ani hajt se nesra të lidhi më to, kismet “. Me këtë konsiderohet se është përfunduar shtytja pa marrë parasysh se a ka pasur sukses shtytësi që të shtytë që të kryej veprën penale, sepse në rastin konkretë me angazhimin e njesivë policorë është bërë bastisja e objektëve, ku në garazhen e M. A. është gjetë dhe konfiskuar saija e narkotikut të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi dhe vepra penale ka mbet në tentativë .

I akuzuari ka qenë i vetëdijshëm se me veprimin e tij do të shkaktojë pasojë të ndaluar në botën e jashtme, pasojë kjo që në ligj është e paraparë si veprë penale sepse ka dëshiruar ndermarjen e veprimeve. Në veprimet e tij egziston faji si relacion psikik ndaj veprës së tij dhe pasojës së asaj veprës e cila shprehet me dashje pasi që O. A. ka ndërmarrur ta kryej veprën penale, por ai akoma nuk ka vendosur definitivisht. Vendimi I tij është I luhatshëm dhe ende është në dilemë a do të kryejë veprën penale – shitjen e narkotikut që e ka vendosur në garazhën e vëllaut,M. dhe I pandehuri R. A. me veprimin e tij me takimin që e ka aranzhuar nëpërmes telefonit me B. ndikon që vendimi i O. të forcohet, të vendosë për të kryer veprën penale.

Në këtë formë Iniciativa për të kryer veprën penale nuk ka filluar nga I akuzuari R. A., shtytja nga ana e tij është e drejtuar me qëllim të kryerjes së veprës penale të caktuar . I akuzuari është angazhuar seriozisht për ta bindur të pandehurin O. A. që ky të tentojë gjithësesi për t’ua shitur blerësve të sipërpërmendur lëndën narkotike .

Me rastin e vendosjes lidhur me lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjithat rrethanat lehtësuese dhe rënduese ne kuptim të nenit 73 të KPRK –së të cilat mund të ndikojnë në lartësinë dhe llojin e dënimit për të akuzuarin R. A. . Kështu si rrethanë lehtësuese gjykata e ka vlerësuar se ma parë nuk ka qenë i gjykuar dhe se nuk zhvillohet procedurë për ndonji vepër tjetër penale, ka marr edhe sjelljen e tij korekte gjatë seancave gjyqësore, që për asnji çast nuk e ka penguar në asnji mënyrë zhvillimin e procedurës penale, që është i martuar dhe është prind i pesë fëmijëve të mitur dhe se ky është mbajtës i vetëm i familjes. Si rrethanë rënduese gjykata morri rrezikimin , apo dëmtimin të vlerës së mbrojtur. Prandaj duke i vlerësuar në këtë mënyrë rrethanat lehtësuese dhe rënduese , gjykata është e bindur se dënimi i shqiptuar është barazëpeshë me shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, intezitetin e pasojës së shkaktuar dhe me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, në kuptim të nenin 41 të KPRK-së, që ka për qëllim parandalimin e kryesëve penale nga të akuzuarit, por edhe nga personat tjerë. se do të ndikojë në risocializimin dhe riedukimin e tyre si dhe të tjerëve që mos të kryejnë vepra penale, për çka është edhe qëllimi i dënimit.

Vendimi mbi llogaritjen e paraburgimit në dënimin e shqiptuar, është marrë konform nenit 83 parg 1 të KPRK –së.

Vendimi mbi obligimin e të akuzuarit për pagesen e shpenzimeve të procedurës penale dhe për paushallin gjyqësorë është marr konform nenit 450 parg2 nëparg 2.6 të KPPRK –së.

Nga sa u tha më lartë, u vendosë si në dispozitiv të këtij aktgjykimi .

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË
DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA
PKR.nr.468/15, të dt.04.04.2016.

Sekretari Juridik,
Arianit Mahmutaj

Kryetarja e trupit - gjyqtarja,
Shadije Gërguri

KESHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 /pesëmbëdhjetë/ ditë nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e përmes kësaj Gjykate.